

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe procesmbajtësen Dalina Kërçeli - Abdullahu - zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.S., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me shenjë PP/I.nr.267/2017, të datës 09.02.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 10.07.2024, në prezencën e Prokurores së shtetit D.H. të akuzuarit L.S. dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare avokate D. L., me datë 12.07.2024 mori dhe publikisht shpalli, si dhe përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.S., me nofkën L., nga i ati S. dhe e ëma H. (e lindur M.) e lindur me datë ..., në fshatin A..., Komuna e S..., me vendqëndrim në K..., rruga “M... M...”, numër ..., me numër personal të identifikimit, të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, ka të përfunduar shkollën fillore, punon në “L... P...” (lojëra të fëmijëve) në K..., kohë pas kohe punon edhe në ndërtimtari, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa martuar, Shqiptar - Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I pandehuri L.S. ka poseduar pa autorizim substanca narkotike brenda institucionit korrektues, më datë 11.03.2017, rreth orës 08:10/h në Qendrën e Paraburgimit në L. në dhomën A.. të krahut A, gjatë kontrollës në dhomën e të pandehurit L.S., nga ana e oficerit korrektues të kësaj Qendre, është gjetur në shtratin e të pandehurit L.S. e fshehur një qese e mbushur me një sasi substancë narkotike të llojit marihuanë e cila substancë narkotike është konfiskuar nga ana e njësitit të hetuesisë për ekzaminim dhe në bazë të Raportit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë, është konstatuar se substanca narkotike është e llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto: 1.77 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, lidhur me nenet 275 paragrafi 1 dhe 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së, si dhe neneve 276, 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje KPPRK) të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, e gjashtë (6) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200,00 (dyqind) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), më peshë neto: 1.77 gram.

DETYROHET Policia e Kosovës - Njësi DHTN - DKKO në Prishtinë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të e bëjë shikimin dhe asgjësimin e substancës narkotike të lartcekur.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, të e paguajë shumën prej 100,00 (njëqind) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit e Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Aktakuza

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën me shenjën PP/I.nr.267/2017, të datës 09.02.2023, kundër të pandehurit L.S., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së.

Kompetenca e gjykatës

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK) kompetencë territoriale për t'u gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar L.S. ka të bëjë me territorin e Prishtinës, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se vepra penale Posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1, lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së, është përcaktuar si krim i rëndë me nenin 22 të KPPRK-së, andaj gjykata konstaton se Departamenti për Krime të Rënda, ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi fillestar

Gjykata pasi që fillimisht kishte vlerësuar kompetencën, si dhe ka vlerësuar të metat formale dhe juridike të aktakuzës, duke vepruar sipas kësaj çështjeje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 10.07.2024 në të cilin kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, i akuzuari i lartcekur në deklarin e tij për fajësinë ishte deklaruar si vijon: *“E pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohem, pendohem, jam njeri familjar dhe kujdesem për prindërit, premtoj se nuk do përsërisë veprën penale dhe kërkojë nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë”*.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L.S. ishte deklaruar si vijon: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit L.S. për veprën penale Posedimi i paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së, ngase pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me dispozitat e KPPRK-së, me gjendjen faktike të përshkuar në aktakuzë dhe me provat dhe dëshmitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës. I ka propozuar gjykatës që të e aprovojë pranimin e fajësisë.

Lidhur me deklarin e të mbrojturit të saj për pranimin e fajësisë Avokate D. L. ishte deklaruar si vijon: e mbështesë fjalën e të mbrojturit tim lidhur me pranimin e fajësisë e cila me aktin akuzues i vihet në barrë si dhe ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese nga neni 70 i KPRK-së dhe veçanërisht rrethanën e pranimin të fajësisë. Me kërkesë për gjykatën që të e aprovojë pranimin e fajësisë.

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari, ka vlerësuar se i akuzuari e kishte kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, duke e aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, andaj konform nenit 242 paragrafi 6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprave penale

Gjykata ka vlerësuar format e kryerjes së veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet”*, ndërsa dispozita ligjore e nenit 281, paragrafi 1, pika 1.8 të Kodit të lartcekur, ka përcaktuar se: *“Nëse vepra penale nga nenet 273, 274, 275, 276 ose 278 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse: vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues”*.

Në rastin konkret i akuzuari L.S., ka poseduar pa autorizim substancë narkotike të llojit Kanabis (Marihuanë) Tetrahidrokanabinol (THC), në peshë neto: 1.77 gram dhe e njejta sasi e narkotikut është gjetur brenda Institucionit Korrektues, gjegjësisht në Qendrën e Paraburgimit në L., ashtu që duke u bazuar edhe në dispozitat ligjore të specifikuara si më sipër, gjykata konstaton se në tërësi janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, pika 1.8 të KPRK-së, e cila i vihet në barrë të të akuzuarit.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të sanksionit penal

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që fakti se i njëjti e ka pranuar fajësinë duke shprehur pendesë, tregon se ndjehet përgjegjës për veprimet e tij, çka tregon nivel të ndërgjegjësimit të të kuptuarit dhe reflektimit mbi sjelljet e tij. I njëjti është person familjar dhe ushtron kujdesin ndaj prindërve të tij, me gjendje shëndetësore jo të mirë bazuar në dokumentacion që gjendet në shkresat e lëndës si dhe ka gjendje të vështirë ekonomike.

Si rrethana rënduese për të njëjtin, ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit të kryer me dashje direkte dhe paramendim. Po ashtu si rrethanë rënduese mori edhe faktin se i akuzuari është i dënuar edhe më parë me aktgjykime të formës së prerë sipas lëndëve me shenjë P.nr.203/2014 për vepër penale nga neni 188 të KPRK-së, i gjykuar me katër (4) muaj burg me kusht për një (1) vit, i formës së prerë me datë 29.12.2017; P.nr.211/2014 për vepër penale nga neni 188 të KPRK-së, i gjykuar me katër (4) muaj burg, me kusht për një (1) vit i formës së prerë me datë 26.06.2017; P.nr.230/2014 për vepër penale nga neni të 275 KPRK-së, i gjykuar me 300,00 (treqind) euro gjobë i formës së prerë me datë 25.05.2017; P.nr.07/2015 për vepër penale nga neni 188 të KPRK-së, i gjykuar me 400,00 (katërqind) euro gjobë, i formës së prerë me datë 26.04.2016; P.nr.21/2015 për vepër penale nga neni 188 të KPRK-së, i gjykuar me katër (4) muaj burg, i formës së prerë me datë 28.08.2017; P.nr.72/2015 për vepër penale nga neni 374 të KPRK-së, i gjykuar me tre (3) muaj burg, me kusht për një (1) vit, i formës së prerë me datë 22.12.2019; P.nr.85/2017 për vepër penale nga nenet 275 dhe 281 të KPRK-së, i gjykuar me 900,00 (nëntëqind) euro gjobë, i formës së prerë me datë 16.11.2017; P.nr.173/2015 për vepër penale nga neni 329 të KPRK-së, i gjykuar me tre (3) vjet, e gjashtë (6) muaj burg dhe 500,00 (pesëqind) euro gjobë. i formës së prerë me datë 27.05.2016; P.nr.139/2014 për vepër penale nga neni 401 të KPRK-së, i gjykuar me 500,00 (pesëqind) euro gjobë dhe një (1) vit burg, me kusht për dy (2) vjet, i formës së prerë me datë 02.09.2022; P.nr.218/2021 për vepër penale nga neni 185 të KPRK-së, i gjykuar me gjashtë (6) muaj burg, me kusht për një (1) vit, i formës së prerë

me datë 10.08.2023, vendime këto të cilat janë siguruar nga Sistemi i evidencës penale të kësaj gjykate.

Gjykata duke i vlerësuar të gjitha rrethanat e lartcekura ka shqiptuar dënimin nën kufirin e paraparë ligjor duke aplikuar dispozitën ligjore nga neni 75 të KPRK-së, *për zbutjen e dënimit*, përkatësisht paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të nenit të lartpërmendur, i cili ka paraparë se: *“Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”*, tutje dispozitën ligjore nga neni 76 të KPRK-së, me të cilin janë përcaktuar *kufijtë e zbutjes së dënimeve*, gjegjësisht paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të nenit në fjalë, i cili ka paraparë se: *“Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 të këtij Kodi (si më sipër) gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të mundësoj risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikoj edhe tek tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmoj në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, i cili është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, është marrë konform nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 449 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 452 paragrafi.1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi në

emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marrë konform neneve 275 paragrafi 3, të KPRK-së, si dhe nenit 276 paragrafi 1 dhe 2, pika 2.2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.92/23, datë 12.07.2024

Zyrtare ligjore,
Dalina Kërqeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.